



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

NR. ___/2024

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 52/2014 “PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Në ligjin nr. 52/2014, “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 1, në fund të fjalisë, pas fjalëve “...interesave të konsumatorit.” shtohen fjalët “...dhe të kontribuojë në stabilitetin financiar.”.

Neni 2

Në nenin 4, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

² Direktivën 2009/138/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 25 nëntor 2009, “Për fillimin dhe zhvillimin e veprimtarive të sigurimit dhe të risigurimit” (Direktiva për aftësinë paguese - Solvency II), (riformulim). Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 335, datë 17.12.2009, fq. 1-155, CELEX nr. 32009L0138;

- Direktivën (BE) 2016/97 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 janar 2016, “Për shpërndarjen në sigurime” (riformulim). Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 26, datë 02.02.2016, fq. 19-59, CELEX nr. 32016d0097

“1. “Administrator” është personi sipas përcaktimit në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Pika 5, ndryshohet si më poshtë:

“5. “Aktuari” është personi i licencuar nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të këtij ligji.”.

3. Pika 13, ndryshohet si më poshtë:

“13. “Funksionar kryesor” është drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm, drejtuesi i njësisë së përputhshmërisë, drejtuesi i njësisë së administrimit të rrezikut dhe aktuari.”.

4. Pas pikës 13, shtohet pika 13/1, me përmbajtje si më poshtë:

“13/1. “Funksion kryesor” brenda një sistemi rregullator, është një detyrë e cila përfshin funksionin e administrimit të rrezikut, funksionin e përputhshmërisë, funksionin e auditit të brendshëm dhe funksionin aktuarial.”.

5. Pika 14, ndryshohet si më poshtë:

“14. “Familjarë të afërm” janë personat në kuptim të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

6. Pika 16, ndryshohet si më poshtë:

“16. “Institucion financiar” është:

- a) një bankë, dhe/ose një subjekt financiar jo bankë sipas përcaktimeve në ligjin “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- b) një shoqëri sigurimi dhe/ose risigurimi sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- c) një shoqëri komisionere, sipas përcaktimeve në ligjin “Për tregjet e kapitalit”;
- ç) një shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, sipas përcaktimeve në ligjin “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
- d) një shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat, sipas përcaktimeve në ligjin “Për fondet e pensionit privat”.

7. Në pikën 43, pas fjalëve “...është personi juridik i licencuar...” shtohen fjalët “...nga Autoriteti...”.

8. Pas pikës 51, shtohet pika 51/1, me përmbajtje si më poshtë:

“51/1. “Mjet i qëndrueshëm komunikimi” është çdo mjet komunikimi, i cili:

- a) i jep mundësi konsumatorit të ruajë informacionin që i drejtohet personalisht, ta shohë dhe ta përdorë në të ardhmen për qëllimet e këtij informacioni; dhe
- b) mundëson riprodhimin e pandryshuar të këtij informacioni”.

Neni 3

Në nenin 10, pika 3, pas fjalëve “...investimet e huaja...” shtohet fjala “...direkte...”.

Neni 4

Në nenin 16, pika 2, shkronja “a”, nënpika “i”, fjalët “...audituesit të autorizuar...” zëvendësohen me fjalët “...audituesit ligjor...”.

Neni 5

Neni 17, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 17

Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi

1. Çdo person, që është ose do të jetë aksionar influencues, anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administrator/anëtar i bordit të drejtorëve, kontrollues kryesor, funksionar kryesor i shoqërisë së sigurimit, duhet të plotësojë kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi në lidhje me pozicionin përkatës.

2. Autoriteti vlerëson nëse aksionari influencues, anëtari i këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratori/anëtari i bordit të drejtorëve, funksionari kryesor i shoqërisë së sigurimit apo kontrolluesi kryesor është i përshtatshëm dhe ka aftësi për të mbajtur pozicionin përkatës në shoqërinë e sigurimit. Për të përcaktuar nëse një person është i përshtatshëm dhe i aftë, Autoriteti bën një vlerësim të veprimtarisë tregtare, financiare dhe sjelljes së personit në të shkuarën, ku ndër të tjera vlerëson:

- a) integritetin;

Në vlerësimin e integritetit, Autoriteti shqyrton nëse personi:

- i. është në proces hetimor, është në proces gjyqësor, është shpallur fajtor me

vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë, krime ekonomike apo financiare, vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare, për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, për pastrimin e parave si dhe financimin e terrorizmit ose për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;

- ii. ka vepruar në kundërshtim me ndonjë nga kërkesat dhe standardet ligjore shqiptare, të ndonjë autoriteti tjetër rregullator, apo të ndonjë autoriteti tjetër të huaj;
- iii. është përjashtuar ose pezulluar për ndonjë shkelje të rëndë nga një organ rregullator.

b) aftësitë profesionale;

Në vlerësimin e aftësive profesionale, Autoriteti shqyrton nëse personi:

- i. përmbush kërkesat përkatëse profesionale për detyrën që kryen ose ka për qëllim të kryejë, të përcaktuara nga Autoriteti në funksion të administrimit të mirë dhe të kujdesshëm të shoqërisë;
- ii. nëpërmjet përvojës profesionale dëshmon se është i përshtatshëm për të kryer funksionin.

c) aftësitë financiare;

Në vlerësimin e aftësive financiare, Autoriteti shqyrton nëse personi:

- i. është përfshirë, ka bashkëpunuar ose është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose
- ii. ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të drejta të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare ose ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila ka provokuar gjendjen e falimentit, ka fshehur gjendjen e falimentit ose ka fshehur pasurinë pas hapjes së procedurave të falimentit, sipas dispozitave të legjislacionit penal;
- iii. është ose ka qenë i përfshirë në evazion fiskal, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit ose në ndonjë praktikë tregtare, të cilën Autoriteti e konsideron të papërshtatshme, për shkak se krijon dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.

3. Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi duhet të përmbushen nga personat e përcaktuar në këtë nen, gjatë gjithë kohës që janë në detyrë. Shoqëria e sigurimit ka detyrimin që të vërtetojë përputhshmërinë e personave në fjalë me këto kërkesa, në momentin e aplikimit si edhe gjatë gjithë kohës që këta persona janë në detyrë. Autoriteti monitoron dhe kur e gjykon të nevojshme kërkon nga shoqëria e sigurimit të vërtetojë përshtatshmërinë dhe aftësinë e tyre sa herë e vlerëson të arsyeshme.

4. Autoriteti përcakton rregulla të detajuara për mënyrën e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve, në përputhje me pozicionin dhe përgjegjësitë e çdo personi, subjekt i këtij neni, sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e sigurimeve.”.

Neni 6

Në nenin 20, pika 1, bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Pas fjalëve “...duhet të përmbushë...” shtohet fjala “...edhe...”.
2. Shkronja “a”, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“a) të ketë të paktën diplomë universitare të ciklit të dytë dhe kualifikime profesionale, të nevojshme për administrimin e kujdesshëm të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit;”.

Neni 7

Në nenin 22, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në në fund të titullit të nenit shtohen fjalët “...dhe administratorëve”.
2. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtje si më poshtë:

“3/1. Përveç detyrave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, këshilli i administrimit/mbikëqyrës është përgjegjës për miratimin e politikës së shpërblimit për drejtuesit e lartë dhe punonjësit e tjerë të shoqërisë, duke patur në konsideratë shkallën e ndikimit të veprimeve të tyre në ekspozimin ndaj rrezikut të shoqërisë.”.

Neni 8

Në nenin 25, pika 3, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“3. Shoqëria e sigurimit njofton dhe merr miratim nga Autoriteti në rastin e riemërimit të administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve dhe anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe njofton Autoritetin në rastin e përfundimit apo marrjes të detyrës si anëtar i një organi drejtues apo kontrollues të një shoqërie tjetër.”.

Neni 9

Neni 27, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 27

Sistemi i administrimit të rrezikut

1. Shoqëria e sigurimit/risigurimit krijon një sistem efektiv për administrimin e rrezikut, i cili përfshin strategjitë, proceset dhe procedurat e raportimit që nevojiten për të identifikuar, matur, monitoruar, administruar dhe raportuar në vijimësi rreziqet, në nivel shoqërie dhe në nivel grupi, me të cilat është përballur ose mund të përballlet, si dhe ndërvarësitë ndërmjet këtyre rreziqeve.

2. Sistemi i administrimit të rrezikut duhet të jetë i mirë integruar në strukturën organizative dhe në proceset vendimmarrëse të shoqërisë, duke marrë në konsideratë rolin e personave që mbajnë funksione drejtuese si dhe funksionarët e tjerë kryesorë.

3. Politikat, procedurat e zbatimit, kufijtë dhe veprimtaritë që lidhen me administrimin e rrezikut duhet të jenë të mjaftueshme për të administruar aspekte të ndryshme të rreziqeve, të cilat krijohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

4. Sistemi i administrimit të rrezikut duhet të fokusohet të paktën në:

- a) procesin e marrjes në sigurim, krijimin dhe mbajtjen e provigjoneve teknike;
- b) menaxhimin e aseteve dhe detyrimeve;
- c) likuiditetin e shoqërisë dhe administrimin e rrezikut të përqendrimit;
- ç) administrimin e rrezikut operacional;
- d) risigurimin dhe teknikat e tjera për zbutjen e rreziqeve.

5. Të gjitha politikat dhe procedurat e ndërmarra nga shoqëria e sigurimit, në kuadër të administrimit të rrezikut, duhet të jenë të dokumentuara dhe të përditësuara në çdo kohë.

6. Shoqëria e sigurimit duhet të krijojë një funksion për administrimin e rrezikut në mbështetje të zbatimit të sistemit të administrimit të rrezikut.

7. Të gjitha përcaktimet e këtij neni në lidhje me krijimin dhe funksionimin e sistemit të administrimit të rrezikut zbatohen edhe për grupin.

8. Autoriteti miraton rregullore për organizimin e sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit.”.

Neni 10

Pas nenit 27, shtohen nenet 27/1 dhe 27/2, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 27/1

Vetëvlerësimi i Rrezikut dhe Aftësisë Paguese

1. Shoqëria e sigurimit/risigurimit kryen vetëvlerësimin e rrezikut dhe aftësisë paguese si pjesë e sistemit të administrimit të rrezikut. Ky vlerësim përfshin të paktën:

- a) nivelin e kapitalit të kërkuar në raport me profilin e rrezikut, kufijtë e miratuar të tolerancës ndaj rrezikut, si dhe strategjinë e biznesit;
- b) pajtueshmërinë në vijimësi me kërkesat për kapital dhe kërkesat për mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike.

2. Vetëvlerësimi i rrezikut dhe aftësisë paguese duhet të jetë pjesë integrale e strategjisë së biznesit dhe duhet të merret në konsideratë, në mënyrë të vazhdueshme, në vendimet strategjike që merr shoqëria.

3. Shoqëria e sigurimit/risigurimit kryen, rregullisht dhe menjëherë pas çdo ndryshimi të konsiderueshëm të profilit të saj të rrezikut, vlerësimin e profilit tërësor të rrezikut dhe aftësisë paguese, në nivel individual dhe/ose grupi, sipas parashikimeve në paragrafin 1, të këtij neni.

4. Shoqëria e sigurimit/risigurimit dokumenton çdo fazë dhe veprim të procesit të vlerësimin të rrezikut dhe të kryerjes së provave të rezistencës, si dhe informon Autoritetin, brenda datës 31 maj të çdo viti, për rezultatet e çdo vetëvlerësimi të rrezikut dhe aftësisë paguese.

5. Të gjitha politikat dhe procedurat e ndërmarra nga shoqëria, në kuadër të administrimit të rrezikut, duhet të jenë të dokumentuara dhe të përditësuara në çdo kohë.

6. Autoriteti miraton rregullore për përcaktimin e afateve dhe përmbajtjes së raportit vjetor të vetëvlerësimin të rrezikut të shoqërisë së sigurimit.”.

“Neni 27/2

Raporti i vetëvlerësimin të rrezikut dhe aftësisë paguese

Raporti i vetëvlerësimin të rrezikut dhe aftësisë paguese përfshin të paktën:

- a) rezultatet cilësore dhe sasiore të vetëvlerësimin të rrezikut dhe aftësisë paguese dhe konkluzionet e nxjerra prej tyre nga shoqëria e sigurimit;
- b) metodat dhe supozimet kryesore të përdorura në vetëvlerësimin e rrezikut dhe aftësisë paguese;
- c) informacion mbi nevojat e përgjithshme të shoqërisë për aftësi paguese dhe krahasimin midis këtyre nevojave me kërkesat rregullatore për kufirin minimal të aftësisë paguese;
- ç) informacion mbi devijime të rëndësishme të rreziqeve që nuk pasqyrohen në llogaritjen e kërkesës për kapital të aftësisë paguese.”.

Neni 11

Në nenin 30, pika 14, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“14. Program për zbatimin e masave, përfshirë një përshkrim të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.”.

Neni 12

Në nenin 34, pika 4, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“4. Në rast të refuzimit të miratimit paraprak nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit ka të drejtë të paraqesë ankim në gjykatën administrative, në përputhje me afatet, kushtet dhe përcaktimet e legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”.

Neni 13

Në nenin 35, pika 5, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“5. Në rastin e refuzimit të licencimit nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit ka të drejtë të paraqesë ankim në gjykatën administrative, në përputhje me afatet, kushtet dhe përcaktimet e legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”.

Neni 14

Në nenin 57, bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Pika 2, ndryshon me përmbajtje si vijon:

“2. Çdo ndryshim i statutit të shoqërisë bëhet me miratim të Autoritetit, brenda 30 ditëve nga depozitimi i tij.”.

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me përmbajtje si vijon:

“2/1. Ndryshimet thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit, bëhen me miratim paraprak të Autoritetit.”.

Neni 15

Neni 63, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

Detyrimi për informim përpara lidhjes së kontratës

1. Siguruesi dhe ndërmjetësit detyrohen t'i japin me shkrim çdo konsumatori, përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me llojin përkatës të sigurimit. Ky informacion përmban:

- a) emrin e shoqërisë, formën juridike dhe strukturore të saj, si dhe adresën e selisë qendrore të shoqërisë;
- b) adresën e selisë qendrore të degës, nëpërmjet së cilës bëhet lidhja e kontratës së sigurimit;
- c) procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe strukturën përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- ç) rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara, si dhe mundësitë për ndryshimin e kontratës, në përputhje me kushtet e përgjithshme;
- d) afatet dhe mënyrat e përfundimit të kontratës;
- dh) metodën e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mospagesës së primit, si dhe pjesën e primit që i korrespondon mbulimit bazë dhe shtesë;
- e) kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit apo shumës së sigurimit;
- ë) metodat e llogaritjes dhe shpërndarjes së bonuseve;
- f) metodën e llogaritjes së vlerës së kompensueshme dhe reduktimin e shumës së sigurimit, në rastin e përfundimit të parakohshëm të pagesave, si dhe shumën deri ku këto janë garantuar nga kontrata e sigurimit;
- g) në rastet e kontratës që lidhet me kuotat/aksionet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, listën e plotë të sipërmarrjeve të caktuara të investimeve kolektive, në të cilat fondet e kontratës së jetës mund të investohen, si dhe karakteristikat e aktiveve, nga të cilat përbëhen fondet e këtyre sipërmarrjeve;
- gj) procedurat jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguruesit pa ndikuar në të drejtën e ankimimit në gjykatë;
- h) kushtet e përfundimit të njëanshëm të kontratës;
- i) të dhëna të përgjithshme për taksat/tatimet dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit;
- j) të drejtën për të paraqitur ankesë pranë shoqërisë së sigurimit.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, i komunikohet konsumatorit si më poshtë:

- a) në formë të shkruar;
- b) në mënyrë të qartë, të saktë dhe të kuptueshme;
- c) në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër për të cilën palët bien dakord; dhe

- ç) pa pagesë.
3. Informacioni përveçse në formë të shkruar, mund t'i jepet konsumatorit edhe në një nga format e mëposhtme:
- nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi; ose
 - nëpërmjet faqes së internetit ku plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 6 të këtij neni.
4. Kur informacioni jepet duke përdorur një mjet të qëndrueshëm komunikimi ose me anë të një faqe interneti, me kërkesë të konsumatorit, ky informacion duhet të jepet edhe në formë të shkruar dhe pa pagesë.
5. Informacioni mund t'i ofrohet konsumatorit duke përdorur një mjet të qëndrueshëm komunikimi, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
- përdorimi i mjetit të qëndrueshëm është i përshtatshëm në kushtet e lidhjes së kontratës ndërmjet rrjetit të shpërndarjes dhe konsumatorit; dhe
 - konsumatorit i është dhënë mundësia të zgjedhë midis informacionit në formë të shkruar dhe marrjes së informacionit nëpërmjet përdorimit të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi dhe e ka pranuar këtë të fundit.
6. Informacioni mund t'i ofrohet konsumatorit nëpërmjet faqes së internetit të shoqërisë, nëse i drejtohet personalisht atij dhe plotësohen kushtet si më poshtë:
- ofrimi i informacionit me anë të faqes së internetit është i përshtatshëm në kushtet e lidhjes së kontratës ndërmjet rrjetit të shpërndarjes dhe konsumatorit;
 - konsumatori ka rënë dakord të marrë informacionin nëpërmjet faqes së internetit;
 - konsumatori është njoftuar në mënyrë elektronike për adresën e faqes së internetit, dhe vendndodhjen e informacionit në këtë faqe;
 - garantohet që ky informacion do të jetë i aksesueshëm në faqen e internetit për një periudhë kohore të arsyeshme që i nevojitet konsumatorit për ta konsultuar.
7. Dhënia e informacionit me anë të një mjeti të qëndrueshëm komunikimi të ndryshëm nga forma e shkruar do të konsiderohet si i përshtatshëm nëse klienti ka një adresë e-maili aktive.
8. Shoqëria e sigurimit dhe/ose ndërmjetësi mund të përdorë sisteme elektronike për lidhjen e kontratave të sigurimit me konsumatorët, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës. Lidhja e kontratës së sigurimit në internet dhe me mjete elektronike, konsiderohet njëjloj e vlefshme me lidhjen me shkrim, nëse konsumatori ka konfirmuar kuptimin e të gjithë informacionit dhe ka pranuar kontratën e sigurimit.
9. Përjashtimisht nga parashikimi i pikës 1, të këtij neni, nëse konsumatori kërkon mbulim të menjëhershëm, informacioni në fjalë mund të jepet verbalisht. Në këtë rast, menjëherë pas lidhjes së kontratës, siguruesi i jep konsumatorit edhe informacionin me shkrim. Lidhja e kontratës së sigurimit, kushteve apo anekseve të saj, nënkupton rënien dakord me informacionin e dhënë verbalisht dhe pranimin e kushteve të saj.
10. Autoriteti përcakton me rregullore procedurën dhe mënyrën e lidhjes së kontratës me mjete elektronike.”.

Neni 16

Në nenin 67, pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si më poshtë:

“5. Shoqëria e sigurimit për çdo informacion promociional njofton Autoritetin 30 ditë para publikimit. Nëse Autoriteti brenda 15 ditëve nga njoftimi, konstaton se përmbajtja e informacionit promociional nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, njofton shoqërinë e sigurimit për korrigjimin ose ndalimin e informacionit promociional.”.

Neni 17

Në nenin 68, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si më poshtë:

“1/1. Në rastet kur shoqëria e sigurimit është pjesë e një grupi, ajo mund të promovojë përkatësinë e saj në grup, si dhe suksesin dhe/ose reputacionin e përgjithshëm të grupit dhe produkteve të tij, por treguesit financiarë të grupit, shoqërive mëmë ose të lidhura, nuk duhet të paraqiten ose të nënkuptohen si rezultate financiare apo performancë e vetë shoqërisë së sigurimit.”.

Neni 18

Në nenin 72, pika 2, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja “ç”, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“ç) në rastet e parashikuara sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe çdo ndryshim material të tij”.

2. Shkronja “e”, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“e) informacioni kërkohet sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Neni 19

Në nenin 79, pika 2, bëhet ndryshimi dhe shfuqizimi si më poshtë:

1. Shkronja “ç”, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“ç) primet e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit/risigurimit ose të arkëtueshme nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90 ditor;”.

2. Shkronja “e” shfuqizohet.

Neni 20

Në nenin 97, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

1. Pikat 1, 3 dhe 4, ndryshohen me përmbajtje si vijon:

“1. Shoqëria e sigurimit lejohet të mbulojë provigjonet teknike, të ndryshme nga ato matematike, me aktivet e listuara më poshtë:

- a) tituj të emtuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë;
- b) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;
- c) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emtuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;
- ç) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;
- d) obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emtuara përmes ofertave private, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
- dh) aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;
- e) aksione, të transferueshme, të shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
- ë) kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të licencuara, njohura apo të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
- f) hua të siguruara dhe të pasiguruara në Republikën e Shqipërisë, vetëm pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara me rregullore nga Autoriteti;
- g) pasuritë e paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat e mëposhtme:
 - i) pasuria e paluajtshme është e pajisur me certifikatë pronësie në emër të shoqërisë së sigurimit;
 - ii) vlera e pasurisë së paluajtshme përcaktohet nga vlerësuesi i licencuar i pavarur, sipas standardeve përkatëse;

- iii) pasuria e paluajtshme jep kthim nga investimi ose pritet të japë kthim nga investimi;
- iv) pasuria nuk është e vendosur si kolateral, apo nuk është vënë peng mbi të, si dhe është e lirë nga çdo barrë tjetër;
- gj) depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.”.

“3. Me miratimin paraprak të Autoritetit, aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, duke përfshirë ato matematike, mund të investohen edhe në:

- a) titujt e borxhit të emetuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose nga një prej autoriteteve rajonale ose vendore të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian ose vendi anëtar të OECD-së;
- b) titujt e borxhit të emetuar nga organizmat publikë ndërkombëtarë, ku janë anëtarë një ose më shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian;
- c) titujt e borxhit të emetuar nga Banka Qendrore Evropiane ose nga bankat qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian;
- ç) aksionet e kapitalit të bankave qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian;
- d) titujt e garantuar pa kushte dhe në mënyrë të përvokueshme nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose nga një prej autoriteteve rajonale ose vendore të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian.
- dh) aksione që tregtohen në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar të Bashkimit Evropian ose vend anëtar të OECD-së;
- e) kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat marketohen apo tregtohen në një vend anëtar të Bashkimit Evropian ose vend anëtar të OECD-së.”.

“4. Në raste të veçanta dhe me kërkesë të shoqërisë së sigurimit, Autoriteti mund të miratojë përkohësisht me një vendim të arsyetuar dhe lloje të tjera aktivesh për të mbuluar provigjonet teknike, nëse këto aktive plotësojnë kërkesat e pikës 2, të këtij neni.”.

2. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si më poshtë:

“4/1. Nuk do të konsiderohen aktive në mbulim të provigjoneve teknike për shoqërinë e sigurimit:

- a) pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera

- financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind;
- b) investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës;
- c) pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur, si dhe investime të tjera në një shoqëri tjetër sigurimi ose ente financiare, të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, e llogaritur përpara zbritjes së elementeve të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike.”.

Neni 21

Në nenin 103, bëhen ndryshimet, shfuqizimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1, shkoronja “ç”, shfuqizohet.

2. Në pikën 1, shkronja “f”, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“f) pasuritë e paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat e mëposhtme:

- i) pasuria e paluajtshme është e pajisur me certifikatë pronësie në emër të shoqërisë së sigurimit;
- ii) vlera e pasurisë së paluajtshme përcaktohet nga vlerësuesi i licencuar i pavarur, sipas standardeve përkatëse;
- iii) pasuria e paluajtshme jep kthim nga investimi ose pritjet të japë kthim nga investimi;
- iv) pasuria nuk është e vendosur si kolateral, apo nuk është vënë peng mbi të, si dhe është e lirë nga çdo barrë tjetër;”.

3. Pika 3 ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“3. Me miratimin paraprak të Autoritetit, aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, duke përjashtuar ato matematike, mund të investohen edhe në:

- a) titujt e borxhit të emetuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose nga një prej autoriteteve rajonale ose vendore të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian ose vendi anëtar të OECD-së;
- b) titujt e borxhit të emetuar nga organizmat publikë ndërkombëtarë, ku janë anëtarë një ose më shumë shtete anëtare të Bashkimit Evropian;
- c) titujt e borxhit të emetuara nga Banka Qendrore Evropiane ose nga bankat

- qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian;
- ç) aksionet e kapitalit të bankave qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian;
 - d) titujt e garantuar pa kushte dhe në mënyrë të parevokueshme nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose nga një prej autoriteteve rajonale ose vendore të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian.
 - dh) aksione që tregtohen në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar të Bashkimit Evropian, ose vend anëtar të OECD-së;
 - e) kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat marketohen apo tregtohen në një vend anëtar të Bashkimit Evropian ose vend anëtar të OECD-së.”.

3. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si më poshtë:

“4/1. Nuk do të konsiderohen aktive në mbulim të provigjoneve matematike për shoqërinë e sigurimit:

- a) pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind;
- b) investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën “a”, të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës;
- c) pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur, si dhe investime të tjera në një shoqëri tjetër sigurimi ose ente financiare, të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, e llogaritur përpara zbritjes së elementeve të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike.”.

Neni 22

Në nenin 109, pas fjalëve “...në përputhje me...”, shtohen fjalët “legjislacionin në fuqi në lidhje me raportimin financiar si dhe...”.

Neni 23

Në nenin 111, pika 1, pas fjalëve “...në përputhje me...” shtohen fjalët “legjislacionin në

fuqi në lidhje me raportimin financiar si dhe...”.

Neni 24

Në nenin 121, pika 6, pas fjalëve “...monitorimin e ushtrimit të veprimtarisë...” shtohen fjalët “...përfshirë identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të përputhshmërisë...”.

Neni 25

Pas nenit 121, shtohet neni 121/1, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 121/1

Përputhshmëria

Shoqëria e sigurimit duhet të parashikojë funksionin e përputhshmërisë, që përfshin raportimin tek këshilli administrimit/mbikëqyrës në lidhje me përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë me këtë ligj dhe kuadrin rregullativ. Funksioni i përputhshmërisë identifikon dhe vlerëson rrezikun e përputhshmërisë në aktivitetet e shoqërisë që vjen nga çdo ndryshim ligjor apo rregullativ.”.

Neni 26

Në nenin 124, pika 1, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“1. Për auditimin e pasqyrave financiare, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, zbatohen dispozitat në fuqi të kuadrit rregullator të fushës së auditimit ligjor.”.

Neni 27

Në nenin 126, pika 1, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“1. Shoqëria audituese auditon dhe vlerëson pajtueshmërinë e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi auditimin ligjor, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) si dhe SNRF.”.

Neni 28

Në nenet 141 dhe 142, fjalët "...grup kontrollues sigurimi i përzier..." zëvendësohen me fjalët "...shoqëri kontrolluese sigurimi e përzier...", sipas kuptimit të fjalisë.

Neni 29

Në nenin 143, pika 2, në fillim të fjalisë, pas fjalës "Shoqëria..." hiqet fjala "...e sigurimit...".

Neni 30

Neni 145, ndryshohet si më poshtë:

"Neni 145

Sistemi i qeverisjes dhe administrimit të rrezikut të grupit

1. Qeverisja e shoqërisë së sigurimit në nivel grupi, duhet të organizohet duke parashikuar përgjegjësitë e organeve drejtuese në nivel grupi, të cilat janë këshilli administrimit/mbikëqyrës ose organet vendimmarrëse/drejtuese të shoqërisë mëmë, si edhe të këshillit administrimit/mbikëqyrës, ose organet vendimmarrëse/drejtuese të shoqërive që janë pjesë e grupit.

2. Anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës ose organeve vendimmarrëse/drejtuese të shoqërisë mëmë, duhet të kenë aftësi dhe njohuri të përshtatshme për organizimin e grupit, politikat e biznesit të shoqërive pjesë e grupit, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe rreziqet që rrjedhin nga struktura e grupit.

3. Këshilli i administrimit/mbikëqyrës ose organet vendimmarrëse/drejtuese të shoqërisë mëmë duhet të:

- a) mbajnë komunikim të vazhdueshëm dhe të duhur me këshillin e administrimit/mbikëqyrës, ose organet vendimmarrëse/drejtuese të të gjitha shoqërive të grupit;
- b) sigurohen që politikat e çdo shoqërie sigurimi të jenë në përputhje me politikat e grupit dhe të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme;
- c) sigurohen që kërkesat e auditimit të brendshëm janë të njëjta, nga të gjitha shoqëritë e sigurimit, si dhe duhet të koordinojnë aktivitetin e auditimit të brendshëm në të gjithë grupin;
- ç) të kenë dhe të zbatojnë rregulla dhe procedura për të identifikuar, matur,

- administruar, monitoruar dhe raportuar rreziqet ndaj të cilave është ekspozuar apo mund të ekspozohet grupi dhe shoqëritë e veçanta, përfshirë edhe përqendrimet e rrezikut;
- d) sigurohen që aftësia paguese e çdo shoqërie sigurimi të grupit të mos rëndohet nga ekzistenca e marrëveshjeve ose transaksioneve brenda grupit;
 - dh) kërkojnë nga aktuari i autorizuar i shoqërisë së sigurimit mëmë, ose shoqërisë së sigurimit që zotëron pjesën më të madhe të aktiveve në grup, të japë opinion mbi politikën dhe programin e risigurimit për grupin në tërësi;
 - e) dokumentojnë delegimin e funksioneve sipas përcaktimeve të nenit 53, të këtij ligji, në shoqëri brenda grupit, si edhe të sigurojnë që kryerja e këtyre funksioneve nuk cenon funksionimin normal të shoqërisë për shkak të këtij delegimi.”.

Neni 31

Në nenin 146, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“1. Shoqëria e sigurimit mëmë, shoqëria kontrolluese e sigurimit, shoqëria kontrolluese e sigurimit me aktivitet të përzier ose shoqëria kontrolluese financiare, duhet të llogarisë mjaftueshmërinë e kapitalit të grupit të sigurimit dhe të përfshijë raporte financiare mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të grupit të sigurimit.”.

2. Pas pikës 1, shtohet pika “1/1” me përmbajtje si vijon:

“1/1. Në llogaritjen e kapitalit të grupit nuk lejohet përdorimi i dyfishtë i elementeve të kapitalit ndërmjet shoqërive të ndryshme të grupit. Në llogaritje do të zbriten elementët e mëposhtëm:

- a) çdo aktiv i shoqërisë mëmë që përfaqëson një financim në kapitalin e një prej shoqërive të lidhura të grupit;
- b) çdo aktiv i një shoqërie të lidhur që përfaqëson një financimin në kapitalin e shoqërisë mëmë;
- c) çdo aktiv i një shoqërie të lidhur me shoqërinë mëmë, që përfaqëson një financim në kapitalin e çdo shoqërie tjetër të lidhur të grupit.”.

Neni 32

Në nenin 147, në fillim të fjalisë, pas fjalëve “...masat e mbikëqyrjes...” shtohen fjalët “...ndaj shoqërisë mëmë...”.

Neni 33

Në nenin 149, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si më poshtë:

“1/1. Autoriteti merr masa mbikëqyrëse për shoqërinë e sigurimit mëmë, sipas parashikimeve në këtë seksion, të këtij ligji.”.

Neni 34

Në nenin 150, pika 1, bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Në shkronjën “a”, fjala “etike” hiqet.

2. Pas shkronjës “a”, shtohet shkronja “a/1”, me përmbajtje si vijon:

“a/1) vlerëson se për shkak të ndikimit të papërshtatshëm të ushtruar nga aksionari i saj, shoqëria vepron në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe parimet e administrimit të kujdesshëm;”.

3. Pas shkronjës “i”, shtohen shkronjat “i/1)” dhe “i/2)” me përmbajtje si vijon:

“i/1) shoqëria nuk ka ngritur, ose nuk ka përditësuar në mënyrë periodike sistemin e administrimit të rrezikut ose nuk ka hartuar dhe miratuar politika dhe procedura të qarta për parandalimin e rreziqeve, sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligj;”.

“i/2) shoqëria nuk ka kryer vlerësimin e aftësisë paguese dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligj;”.

Neni 35

Në nenin 152, pika 1, shkronja “i”, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“i) mund të zgjerohë objektin e inspektimit dhe të rrisë shpeshtësinë e inspektimeve në vend, në përputhje me dispozitat e nenit 136, të këtij ligji, ose të caktojë punonjësit e autorizuar për inspektim në shoqërinë e sigurimit për të monitoruar situatën në vazhdimësi, nëse Autoriteti e shikon të nevojshme;”.

Neni 36

Në nenin 153, pika 1, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në shkronjën “a”, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “...dhe/ose nivelin e kërkuar të aftësisë paguese sipas nenit 80, të këtij ligji;”.
2. Në shkronjën “ë”, pas fjalëve “...të miratuara nga Autoriteti...” shtohen fjalët “...në rast se:”, si dhe shtohen nënpikat “(i)” “(ii)” “(iii)” (iv)” me përmbajtje si vijon:

- “(i) shoqëria nuk përmbush parashikimet e këtij ligji në lidhje me provigjonet teknike/matematike;
- (ii) shoqëria nuk përmbush parashikimet e këtij ligji në lidhje me nivelin e kërkuar të aftësisë paguese dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike;
- (iii) në rrethana të jashtëzakonshme, kur situata financiare e shoqërisë pritet të përkeqësohet edhe më tej, pavarësisht masave të referuara në nenet 82 dhe 83, të këtij ligji;
- (iv) nëse licenca për ushtrimin e veprimtarisë është revokuar ose pezulluar.”

3. Pas shkronjës “g”, shtohet shkronja “g/1” me përmbajtjen si vijon:

“g/1) urdhëron shoqërinë e sigurimit për marrjen e masave për rritjen e kapitalit;”.

Neni 37

Në nenin 155, shkronja “g”, fjala “...falimentimit...”, zëvendësohet me fjalët “...likuidimit të detyrueshëm...”.

Neni 38

Kudo në nenin 156, fjalët “...pika 1...” hiqen.

Neni 39

Në nenin 161, pika 4, fjala “...kryetar...” zëvendësohet me fjalën “...Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv...”, sipas kuptimit dhe në fund të fjalisë së parë shtohet fjala “...kalendarike”.

Neni 40

Neni 162, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 162

Administratorët e përkohshëm

1. Autoriteti emëron dy ose më shumë administratorë të përkohshëm dhe përcakton llojet dhe qëllimin e detyrave të ushtruara nga çdo administrator i përkohshëm, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit, të cilët duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenet 17 dhe 20, të këtij ligji.

2. Administratorët e përkohshëm nuk duhet të jenë punonjës të Autoritetit.

3. Administratorët e përkohshëm emërohen për një afat jo më të gjatë se një vit me mundësinë që Autoriteti mund të zgjasë këtë afat edhe për një vit tjetër.

4. Shpërblimi dhe kostot e administratorëve të përkohshëm mbulohen nga shoqëria e sigurimit që është nën administrim.

5. Autoriteti përcakton me rregullore, kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e administratorëve të përkohshëm.

Neni 41

Në nenin 166, pika 2, shkronja “d”, fjalët “...apo falimentim...”, zëvendësohen me fjalët “...të detyrueshëm...”.

Neni 42

Në nenin 167, pika 3, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“3. Administratori i përkohshëm vë në dijeni asamblenë e përgjithshme të aksionarëve që, në rast se refuzohet rritja e kapitalit, sipas pikës 1, të këtij neni, shoqëria e sigurimit do të kalojë në likuidim të detyrueshëm, sipas parashikimeve të nenit 175 të këtij ligji.”

Neni 43

Në nenin 168, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si vijon:

“4/1. Në rast se administratori ose anëtarët e mëparshëm të këshillit të administrimit/mbikëqyrës nuk pranojnë riemërimin, administratori i përkohshëm do të vazhdojë detyrën derisa kandidatët e rinj të emërohen nga asambleja e përgjithshme dhe më pas të miratohen nga Autoriteti. Administratori i përkohshëm do të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për dërgimin për miratim të kandidatëve të rinj, pranë Autoritetit.”.

2. Në pikën 5, në fjalinë e dytë, pas fjalëve “...për fillimin e procedurave të likuidimit...”, shtohet fjala “...të detyrueshëm...”.

3. Pas pikës 5, shtohet pika “6” me përmbajtje si vijon:

“6. Autoriteti vendos për revokimin e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi, jo më vonë se 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike:

- a) nga data e përfundimit të afatit kohor për pranimin e raportit përfundimtar mbi rezultatet e vlerësimit të administrimit të përkohshëm, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 168, të këtij ligji;
- b) nga data kur mbledhja e asamblesë së përgjithshme refuzon miratimin e vendimit të propozuar, sipas pikës 1, të nenit 167, të këtij ligji.”.

Neni 44

Në nenin 169, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si vijon:

“1/1. Autoriteti miraton vendimin për likuidimin vullnetar vetëm nëse shoqëria e sigurimit plotëson kërkesat ligjore dhe rregullatore në lidhje me nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike dhe matematike, mbulimin e këtyre provigjoneve me aktive të lejuara, si dhe vlerëson se shoqëria është në gjendje të mbulojë të gjitha detyrimet e saj.”.

Neni 45

Në nenin 170, pika 2, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“2. Likuidatorët janë persona fizikë, të cilët përmbushin kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në nenet 176, 176/1 dhe 176/2 të këtij ligji.”.

Neni 46

Në nenin 171, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si vijon:

“1/1. Vendimi i likuidimit vullnetar, së bashku me miratimin paraprak të Autoritetit, depozitohet në QKB dhe botohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në një ose më shumë media kombëtare në formë të shkruar apo audiovizive.”.

2. Pika 2, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“2. Autoriteti, pas marrjes së njoftimit, sipas pikës 1, të këtij neni, vendos revokimin e licencës, si dhe përcakton:

- a) veprimtarinë e nevojshme për kryerjen e procedurave të likuidimit të shoqërisë; dhe
- b) deri në çfarë mase zbatohen rregullat e administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit në procedurë likuidimi.”.

Neni 47

Neni 172, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 172

Procedurat e likuidimit vullnetar

Për likuidimin vullnetar zbatohen edhe dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.”.

Neni 48

Neni 173, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 173

Ndodhja në kushtet e likuidimit të detyrueshëm

Nëse likuidatorët gjatë procedurës së likuidimit vullnetar, vlerësojnë se shoqëria ndodhet në kushtet e likuidimit të detyrueshëm, njoftojnë dhe paraqesin menjëherë në Autoritet propozimin për vendosjen e shoqërisë së sigurimit në likuidim të detyrueshëm.”.

Neni 49

Në nenin 175, bëhen ndryshimet dhe shfuqizimi si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Rrethanat për vendosjen e shoqërisë së sigurimit në likuidim të detyrueshëm”.

2. Pika 1, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“1. Autoriteti vendos shoqërinë e sigurimit në likuidim të detyrueshëm në rastet kur:

- a) është revokuar licenca për kryerjen e veprimtarisë së sigurimit, sipas nenit 155 dhe pikës 5, të nenit 168, të këtij ligji;
- b) bazuar në raportin e përmendur në pikën 2, të nenit 166, të këtij ligji, vlerëson se gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm gjendja financiare e shoqërisë nuk përmirësohet në atë masë që shoqëria e sigurimit të arrijë nivelin e aftësisë paguese, të përcaktuar në nenin 80, të këtij ligji;
- c) mbledhja e asamblesë së përgjithshme e shoqërisë së sigurimit, sipas pikës 2, të nenit 167, të këtij ligji, nuk miraton vendimin për rritjen e kapitalit të shoqërisë së sigurimit ose e miraton atë, por dështon shitja e parë e aksioneve;
- ç) nëse asambleja e përgjithshme e aksionarëve refuzon propozimin e parashikuar në pikën 1, të nenit 167, të këtij ligji;
- d) kur Autoriteti, pas vlerësimit të duhur të rrethanave, vendos që likuidimi vullnetar të refuzohet ose kur gjatë zbatimit të likuidimit vullnetar konstaton se ky i fundit mund të dëmtojë dhe/ose rrezikojë interesat e kreditorëve;
- dh) kur ka prova të besueshme që administratorët e shoqërisë së sigurimit janë përfshirë në transaksione të jashtëligjshme, kanë kryer mashtrime ose kanë përfituar personalisht dhe i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme shoqërisë së sigurimit ose personave të tretë;
- e) nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së shoqërisë së sigurimit konstaton ndonjë rast tjetër që përbën arsye për likuidim, sipas përcaktimeve të këtij ligji.”

3. Pika 2, shfuqizohet.

Neni 50

Pas nenit 175, shtohen nenet 175/1 dhe 175/2, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 175/1

Vendimi për likuidimin e detyrueshëm

1. Vendimi i Autoritetit për vendosjen e shoqërisë së sigurimit në likuidim të detyrueshëm, përmban:

- a) emrin e shoqërisë së sigurimit;
- b) adresën e selisë qendrore;
- c) arsyet për të cilat merret vendimi;
- ç) emrat e plotë të likuidatorëve, detyrat dhe kompetencat e tyre;
- d) datën e fillimit të procedurës së likuidimit;
- dh) revokimin e licencës.

2. Vendimi i Autoritetit për hapjen e likuidimit të detyrueshëm, depozitohet në QKB brenda 3 (tre) ditë pune.”.

“Neni 175/2

Njoftimi për fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar

1. Njoftimi për vendosjen e shoqërisë së sigurimit në likuidim të detyrueshëm, botohet në Fletoren Zyrtare dhe në një ose më shumë media kombëtare në formë të shkruar apo audiovizive.

2. Njoftimi i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni përmban:

- a) kopjen e vendimit të Autoritetit për vendosjen e shoqërisë së sigurimit në likuidim;
- b) ftesën për kreditorët, për të regjistruar pretendimet e tyre pranë likuidatorit;
- c) ftesën për debitorët, për të shlyer menjëherë detyrimet e tyre.”.

Neni 51

Neni 176, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 176

Likuidatorët

1. Autoriteti, bazuar në vendimin për revokimin e licencës së shoqërisë së sigurimit, emëron të paktën dy likuidatorë, të cilët përfaqësojnë shoqërinë e sigurimit dhe përcakton llojin dhe qëllimin e detyrave të secilit prej tyre.

2. Likuidatorët janë persona fizikë, të cilët përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenet 17 dhe 20, të këtij ligji, si dhe nuk mund të jenë punonjës të Autoritetit. Likuidatori nuk mund të jetë personi në rastet kur ai ose familjari i afërt i tij është kreditor, ose person i lidhur me shoqërinë e sigurimit për të cilën vendoset likuidimi, si dhe ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me shoqërinë e sigurimit, sipas përcaktimeve të nenit 176/1, të këtij ligji.

3. Përpara emërimit, personat e propozuar si likuidator të shoqërisë së sigurimit nënshkruajnë një deklaratë me të cilën konfirmojnë plotësimin e kërkesave të përcaktuara në nenet 17, 20 dhe 176/1, të këtij ligji.

4. Likuidatori zëvendësohet kur ai nuk zbaton në mënyrën e duhur detyrat e tij ose kur ai nuk ka më legjitimitetin të veprjës si likuidator. Kur një likuidator zëvendësohet, likuidatori i ri vazhdon të ushtrojë kompetencat e likuidatorit të parë dhe atij i transferohen të gjitha aktivet, librat dhe llogaritë e shoqërisë së sigurimit.

5. Shpërblimi i likuidatorit përcaktohet nga Autoriteti dhe nuk mund të jetë në masë më të madhe se pagesat e punonjësve të shoqërisë së sigurimit për shërbime të ngjashme.”.

Neni 52

Pas nenit 176, shtohen nenet 176/1, 176/2 dhe 176/3, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 176/1

Konflikti i interesit

1. Nuk mund të jetë likuidator i shoqërisë së sigurimit personi në rastet kur ai ose familjarët e tij të afërt ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit, që përfshin:

- a) marrëdhëniet e punës me shoqërinë e sigurimit objekt likuidimi;
- b) të drejtat e pronësisë në shoqërinë e sigurimit objekt likuidimi;
- c) pozicionin e administratorit, punonjësit, drejtorit ose aksionarit me pjesëmarrje influencuese për pesë vitet e fundit, në ndonjë shoqëri tjetër sigurimi;
- ç) marrëdhëniet financiare, tregtare ose marrëdhëniet e ngushta financiare me çdo subjekt me pjesëmarrje influencuese në kapitalin e shoqërisë së sigurimit objekt likuidimi, duke përfshirë informacionin e kontratave të pritshme të

punës ose të negociatave me këtë subjekt.

2. Likuidatori shmang konfliktin e interesit gjatë gjithë procesit të likuidimit. Në rast se personi i emëruar si likuidator vihet në dijeni për konfliktin e interesit, njofton menjëherë Autoritetin, i cili merr masat për të bërë ndryshimet përkatëse.

3. Likuidatori i emëruar nga Autoriteti nuk duhet:

- a) të pranojë ose të kërkojë përfitime, dhurata ose sende të tjera me vlerë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga çdo subjekt:
 - i) për të cilin ai është në dijeni se mund t'i kërkojë ndërhyrje lidhur me procesin e likuidimit; ose
 - ii) i cili ka interesa materiale që mund të cenohet në mënyrë thelbësore nga kryerja ose moskryerja e detyrave;
- b) të përdorë në mënyrë të papërshtatshme ose të lejojë përdorimin në mënyrë të papërshtatshme të pasurisë së tij ose të pasurisë që ai mbikëqyr apo kontrollon, për përfitime vetjake apo të çdo subjekti tjetër;
- c) të bëjë çdo premtim ose veprim të paautorizuar.”.

“Neni 176/2

Pavarësia dhe ruajtja e konfidencialitetit nga likuidatori

1. Likuidatori është i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij, gjatë procesit të likuidimit të shoqërisë së sigurimit.

2. Likuidatori respekton të gjitha kërkesat për ruajtjen e sekretit profesional, konfidencialitetin e informacionit për klientin, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

“Neni 176/3

Detyrat dhe kompetencat e likuidatorit

1. Likuidatori i emëruar nga Autoriteti zbaton detyrat e tij nën mbikëqyrjen e Autoritetit.

2. Likuidatori përfaqëson shoqërinë e sigurimit gjatë procesit të likuidimit të detyruar dhe nënshkruan në të gjitha aktet e dokumentet e nxjerra nga shoqëria e sigurimit, shoqëruar me shënimin “shoqëri sigurimi në likuidim të detyrueshëm”.

3. Likuidatori, merr në zotërim dhe në kontroll shoqërinë e sigurimit dhe aktivet e saj, brenda 3 (tre) ditëve nga data e emërimit të tij, si dhe ushtron kompetenca të plota për administrimin, drejtimin dhe kontrollin e shoqërisë së sigurimit dhe të gjitha aktiveve të saj.

4. Brenda 3 (tre) ditëve nga data e emërimit të tij, likuidatori:
 - a) dërgon në çdo zyrë të shoqërisë së sigurimit dhe ndërmjetësve një njoftim për emërimin e tyre nga Autoriteti;
 - b) publikon njoftimin në një ose më shumë media kombëtare në formë të shkruar apo audiovizive;
 - c) dërgon menjëherë kopje të njoftimit të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike në Autoritet.
5. Likuidatori synon sigurimin e shumës maksimale të aktiveve të shoqërisë së sigurimit, duke ndërmarrë veprime si më poshtë:
 - a) pezullon transaksionet e pagesave të çdo lloji ndaj këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe aksionarëve;
 - b) vazhdon ose ndërpret çdo transaksion bankar ose financiar;
 - c) kryen shitjen e aktiveve duke pasur parasysh maksimizimin e vlerës së tyre;
 - ç) kryen pagesat tek kreditorët sipas radhës së përcaktuar në këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;
 - d) punëson çdo nëpunës, punonjës ose këshilltar profesionist të domosdoshëm, pas marrjes së miratimit nga Autoriteti;
 - dh) ngre padi ose mbron dhe ndjek në emër të tij çdo veprim ose procedurë ligjore.
6. Likuidatori ka të drejtë të përfundojë:
 - a) kontratat e punësimit në shoqërinë e sigurimit me çdo person;
 - b) kontratat e shërbimit, në të cilat shoqëria e sigurimit është palë;
 - c) çdo detyrim, ku shoqëria e sigurimit është qiramarrës i pasurisë së paluajtshme.
7. Likuidatori, me miratimin me shkrim të Autoritetit, mund të marrë hua e cila mund të sigurohet dhe garantohet nga aktivet e siguruesit ose pa garanci.”.

Neni 53

Në nenin 178, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si vijon:

“1/1. Ankimi në gjykatë i vendimit të Autoritetit nuk pezullon procesin e likuidimit të detyrueshëm. Procesi i likuidimit të detyrueshëm zbatohet pa kufizim deri në marrjen e vendimit nga gjykata.”.

2. Pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9, me përmbajtje si vijon:

“3. Likuidatori bëhet përfaqësuesi i vetëm ligjor i shoqërisë së sigurimit dhe të gjitha pretendimet kundrejt shoqërisë i drejtohen likuidatorit.

4. Të gjitha procedurat gjyqësore ndaj shoqërisë së sigurimit pezullohen dhe ndalohet

fillimi i çdo procedure të tillë, me përjashtim të dakordësisë së dhënë nga Autoriteti dhe kushteve të vendosura nga ky i fundit.

5. Ndalohet kryerja e pagesave të huave të shoqërisë së sigurimit.

6. Transferimi i aksioneve të shoqërisë së sigurimit bëhet i pavlefshëm, përveç rasteve kur jepet pëlqimi nga Autoriteti.

7. Çdo kusht ligjor, kontraktual ose i çfarëdoshëm, me mbarimin e afatit të të cilit një detyrim i pretenduar ose një e drejtë e shoqërisë së sigurimit mund të shuhet ose të ngurtësohet, duhet të rivendoset në afat deri në gjashtë muaj nga data e mbarimit të afatit ose të ngurtësimit.

8. Të drejtat e aksionarëve ngurtësohen, përveç të drejtave për të përfituar dividendët nga procedura e likuidimit.

9. Autoriteti udhëzon likuidatorët e emëruar për kryerjen e procedurës së likuidimit të detyruar të shoqërisë së sigurimit, sipas akteve nënligjore të miratuara prej tij.”.

Neni 54

Në nenin 180, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Pavarësisht parashikimit të pikës 1, të këtij neni, shoqëria e sigurimit mund të lidhë kontrata të nevojshme për kthimin e aktiveve në likuiditet, me miratimin paraprak të likuidatorit, si dhe mund të ushtrojë veprimtari që lidhen me transferimin e kontratave të sigurimit të një tjetër shoqëri sigurimi, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

Neni 55

Në nenin 181, bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Në titullin e nenit pas fjalës “...bilancit...” shtohet fjala “...paraprak...”.

2. Në pikën 1, në fillim të fjalisë, pas fjalës “...likuidatori...”, shtohen fjalët “...bën inventarin e aktiveve dhe të pasurive të shoqërisë së sigurimit dhe...”.

3. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen si vijon:

“1/1.Raporti sqarues duhet të përmbajë:

- a) pasqyrat financiare, duke përfshirë sqarimet mbi pozicionet kyçe:
 - i. bilancin e gjendjes;
 - ii. pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve;
 - iii. pasqyra e fluksit të parasë;

- iv. planifikimi i rrjedhës së parasë;
- v. opinionin e auditusit ligjor;
- b) pozicioni i detajuar në banka, përfshirë konfirmimet bankare;
- c) raport mbi dëmet e papaguara të sigurimit, duke përfshirë dëmet në proces gjyqësor;
- ç) listën e aseteve që mbulojnë provigjonet teknike dhe matematike, e cila nuk mund të ndryshohet pasi të ketë filluar procedura e likuidimit. Megjithatë, likuiduesi, me pëlqimin e Autoritetit, mund të bëjë korrigjime teknike të aseteve të listuara;
- d) raport mbi llogaritë e arkëtueshme nga debitorët;
- dh) listën e kreditorëve dhe shumat përkatëse të kompensimit;
- e) dëmet në proces gjyqësor, duke përfshirë shumat e kontestuara;
- ë) raport mbi gjendjen e llogarive të pagueshme;
- f) raport mbi gjendjen e pronave - prona të investuara;
- g) raport mbi gjendjen e llogarive të arkëtueshme.”.

4. Në pikën 2, hiqen fjalët “...në gjykatën kompetente dhe...”.

Neni 56

Fjalët “Seksionin IV” dhe titulli “...Falimentimi...”, hiqen.

Neni 57

Nenet 182 dhe 183, të ligjit, shfuqizohen.

Neni 58

Neni 184, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 184

Kontratat e sigurimit

Në momentin e hapjes së procedurave të likuidimit të shoqërisë së sigurimit, të siguarit apo përfituesit, sipas kontratave të sigurimit, të nënshkruara nga një shoqëri sigurimi, do të quhen kreditorë dhe pretendimet e tyre do të trajtohen sipas radhës së përcaktuar në nenin 186, të këtij ligji”.

Neni 59

Neni 185, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 185

Informimi i Autoritetit

1. Likuidatori përgatit bilancin dhe raporte sqaruese në fund të çdo tremujori dhe raporton në Autoritet brenda 15 ditëve nga përfundimi i tremujorit. Raporti përveç përmbajtjes sipas pikës 1/1, të nenit 181, të këtij ligji, duhet të përfshijë edhe:

- a) raport mbi shitjet dhe shumat e realizuara për çdo aktiv;
- b) raport për të ardhurat nga realizimi i aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike dhe matematike;
- c) raport për shumat e mbledhura nga debitori;
- ç) listën e përfitimeve dhe dëmeve të paguara sipas klasave të sigurimit, duke specifikuar shumën dhe përfituesin;
- d) listën e kreditorëve të tjerë të kompensuar dhe shumën e kompensimit.

2. Kur të ardhurat nga realizimi i aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike dhe matematike janë më të ulëta se vlerësimi i përfshirë në listën e paraqitur sipas shkronjës “ç”, të pikës 1/1, të nenit 181, të këtij ligji, likuidatori informon Autoritetin, duke treguar arsyet e ndryshimit.

3. Likuidatorët raportojnë menjëherë në Autoritet për përfundimin e shpërndarjes së të gjitha aktiveve të shoqërisë së sigurimit, gjatë procesit të likuidimit. Me miratimin e këtij raporti nga Autoriteti, ky i fundit dhe likuidatorët lirohen nga çdo përgjegjësi tjetër, në lidhje me likuidimin e shoqërisë së sigurimit.”.

Neni 60

Neni 186, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 186

Radha e pagesave të pretenduara

1. Pagesat e pretenduara të kreditorëve të shoqërisë së sigurimit në likuidim, sipas parashikimeve të nenit 184, të këtij ligji, realizohen sipas radhës së mëposhtme:

- a) pretendimet e kontratave të sigurimit të jetës dhe kontratave të tjera të sigurimit, të cilat janë subjekt i të njëjtave tabela të probabilitetit dhe llogaritjeve si atotë zbatueshme për sigurimin e jetës, të cilat nuk mund të paguhen nga aktivet në mbulim të provigjoneve matematike;

- b) pretendimet e kontratave të sigurimit të jojetës dhe kontratave të tjera të sigurimit, për të cilat nuk janë krijuar provigjonet matematike në lidhje me kompensimin e humbjes, të ndodhur përpara vendosjes së shoqërisë në likuidim të detyrueshëm, dhe kthimin e një pjese të primit të paguar për periudhën para përfundimit të kësaj kontrate sigurimi;
- c) pretendime që rrjedhin nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve për pagesat nga fondi i kompensimit, përcaktuar në ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe që lidhen me kompensimin e shumës së paguar të dëmeve, për të cilat personat e dëmtuar nuk mund të dëmshpërblehen nga shoqëria e sigurimit për shkak të vendosjes së kësaj shoqërie në likuidim të detyrueshëm;
- ç) pretendime që rrjedhin nga kreditorë të tjerë që nuk përcaktohen në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni;
- d) detyrimet ndaj aksionarëve që rrjedhin nga pronësia mbi aksionet.

2. Pagesa e detyrimeve që i përket një kategorie të mëvonshme në radhë, mund të fillohet vetëm pas pagesës së plotë të detyrimeve të kategorisë, që është më parë në radhë.

3. Pavarësisht pikës 1, të këtij neni, kostot mujore të likuidimit, përfshirë pagat mujore të likuidatorëve dhe personave të punësuar për likuidimin, si dhe shpenzimet e domosdoshme dhe të arsyeshme të bëra nga likuidatori për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, kanë përparësi ndaj radhës së pagesave të pretenduara.

4. Nëpunësit profesionistë, të caktuar dhe të emëruar nga likuidatorët, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe në varësi të kërkesave dhe të kushteve të shërbimit, nuk shpërblehen më shumë se nëpunësit e shoqërisë së sigurimit për të njëjtat shërbime. Përveç sa më sipër, Autoriteti mund të autorizojë pagesën e shumave më të larta, kur arrin në përfundimin se pagesa e këtyre shumave është e domosdoshme për të rekrutuar dhe mbajtur personelin e nevojshëm.”.

Neni 61

Në nenin 188, në pikat 1 dhe 6, fjala “falimentim” zëvendësohet me fjalën “likuidim”, sipas kuptimit të fjalisë.

Neni 62

Neni 189, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 189

Llogaria e veçantë e aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike

1. Përveç llogarisë së përgjithshme të mbajtjes së debitorëve të shoqërisë të vendosur në likuidim të detyrueshëm, likuidatori krijon një llogari të veçantë në para për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike, për kryerjen e pagesave të pretendimeve.

2. Likuidatori i shoqërisë së vendosur në likuidim të detyrueshëm, administron të gjitha transaksionet në para, të marra nga kthimi në likuiditet i aktiveve në mbulim të provigjoneve matematike, nëpërmjet një llogarie të veçantë në para për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike.”.

Neni 63

Në nenin 190, fjalët “...në këshillin e administrimit/mbikëqyrës...”, zëvendësohen me fjalët “...pranë likuidatorëve”.

Neni 64

Neni 191, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 191

Depozitimi i pretendimeve

Pretendimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit i bëhen të ditura likuidatorëve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.”.

Neni 65

Në nenin 194, pika 5, shfuqizohet.

Neni 66

Në nenin 201, bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 5, ndryshon me përmbajtje si vijon:

“5. Në rast të revokimit të licencës nga Autoriteti, shoqëria e agjentëve ka të drejtë

të ankohet pranë gjykatës administrative, në përputhje me afatet, kushtet dhe përcaktimet e legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”.

2. Pas pikës 6, shtohen pikat 6/1 dhe 6/2, me përmbajtje si vijon:

“6/1 Autoriteti mund të revokojë licencën e shoqërisë së agjentëve, nëse nuk kryen aktivitetet për një periudhë më shumë se 6 muaj.

6/2. Me paraqitjen e rrethanave të parashikuara në pikën 6, të këtij neni, shoqëria e agjentëve në sigurime, informon Autoritetin me shkrim.”.

Neni 67

Në nenin 209, bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 4, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me përmbajtje si vijon:

“e) heq dorë vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë.”.

2. Pika 5, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“5. Në rast të revokimit të licencës nga Autoriteti, brokeri ka të drejtë të ankohet pranë gjykatës administrative, në përputhje me afatet, kushtet dhe përcaktimet e legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”.

3. Pas pikës 6, shtohet pika “6/1” me përmbajtje si vijon:

“6/1. Autoriteti me kërkesë të brokerit, mund të vendosë të pezullojë me ose pa afat licencën.”.

Neni 68

Në nenin 211, bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 5, ndryshon me përmbajtje si vijon:

“5. Në rast të revokimit të licencës nga Autoriteti, shoqëria e brokerimit ka të drejtë të ankohet pranë gjykatës administrative, në përputhje me afatet, kushtet dhe

përcaktimet e legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”.

3. Pas pikës 6, shtohen pikat 6/1 dhe 6/2, me përmbajtje si vijon:

“6/1 Autoriteti mund të revokojë licencën e shoqërisë së brokerimit, nëse nuk kryen aktivitet për një periudhë më shumë se 6 muaj.

6/2. Me paraqitjen e rrethanave të parashikuara në pikën 6, të këtij neni, shoqëria e brokerimit në sigurime, informon Autoritetin me shkrim.”.

Neni 69

Në nenin 214, pika 1, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“1.Informacioni i përmendur në nenin 213, të këtij ligji, u komunikohet të siguruarve, sipas përcaktimeve në nenin 63, të këtij ligji.”.

Neni 70

Në nenin 217, pika 1, fjalët “...ligjeve nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, zëvendësohen me fjalët “...ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, sipas kuadrit rregullator të fushës së raportimit financiar,...”.

Neni 71

Në nenin 219, pika 1, pas shkronjës “ç”, shtohet shkronja “d”, me përmbajtje si vijon:
“d) ndërmjetësit në sigurime ndihmëse”.

Neni 72

Neni 220, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 220

Ndërmjetësi në sigurime ndihmëse

1. Ndërmjetës në sigurime ndihmëse nënkupton çdo person fizik ose juridik, përveç institucioneve të kreditit dhe shoqërive të investimit, të cilët ushtrojnë veprimtari ndërmjetësimi në sigurime ndihmëse dhe përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) veprimtaria kryesore profesionale të jetë e ndryshme nga ajo e ndërmjetësimit në sigurime;
- b) personi të ndërmjetësojë vetëm disa produkte sigurimi që janë plotësuese të një malli ose shërbimi;
- c) produktet e sigurimit në fjalë të mos mbulojnë sigurimin e jetës ose rreziqet e përgjegjësisë, përveç rasteve kur janë plotësuese të mallit ose shërbimit që ndërmjetësi ofron si pjesë e veprimtarisë së tij kryesore profesionale;

2. Dispozitat e këtij ligji, nuk zbatohen për ndërmjetësit në sigurime ndihmëse, të cilët gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, plotësojnë njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) sigurimi është plotësues i mallit ose shërbimit të ofruar nga ofruesi, kur ky sigurim mbulon:
 - i) rreziqe të prishjes, humbjes apo dëmtimit të mallrave ose mospërdorim të shërbimit të ofruar nga ofruesi i shërbimit; ose
 - ii) rreziqe të dëmtimit apo humbjes së bagazheve dhe rreziqe të tjera të lidhura me rezervimin e udhëtimeve;
- b) shuma e primit të paguar për produktin e sigurimit nuk tejkalon 75 000 lekë, e llogaritur mbi bazë vjetore;
- c) përjashtimisht nga shkronja “b”, kur sigurimi është plotësues për shërbimin e përmendur në shkronjën “a” dhe kohëzgjatja e këtij shërbimi është 3 (tre) muaj ose më pak, shuma e primit të paguar për person nuk është mbi 25 000 lekë.

3. Kur veprimtaria e shpërndarjes kryhet përmes ndërmjetësit në sigurime ndihmëse, i cili plotëson kushtet e pikës 2, të këtij neni, shoqëria e sigurimit ose ndërmjetësi në sigurime, para lidhjes së kontratës duhet të garantojnë se:

- a) konsumatorit i vihet në dispozicion informacioni rreth identitetit dhe adresës së ndërmjetësit, si dhe informacioni i parashikuar në nenin 213, të këtij ligji, me qëllim që konsumatori ose palët e tjera, të ushtrojnë të drejtën e ankimit;
- b) plotësohen detyrimet e parashikuar nga nenet 58 dhe 239, të këtij ligji, duke marrë në konsideratë kërkesat dhe nevojat e konsumatorit;
- c) konsumatorit i është dhënë informacioni për produktin e sigurimit i përmendur në nenin 63, të këtij ligji.”.

Neni 73

Në nenin 225, bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 1, shkronja “b”, ndryshohet si vijon:

“b) të shprehë gjykimin profesional mbi politikën e përgjithshme të marrjes në sigurim, përfshirë këtu shqyrtimin nëse tarifat e primit të sigurimit janë llogaritur në përputhje me rregullat e profesionit të aktuarit dhe legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të garantojnë mbulimin gjatë gjithë kohës të përgjegjësive të shoqërisë së sigurimit, sipas kontratave të sigurimit.”

2. Në pikën 1, pas shkronjës “b”, shtohen shkronjat “c” dhe “ç” me përmbajtje si më poshtë:

“c) të shprehë mendim mbi përshtatshmërinë e marrëveshjeve të risigurimit;
ç) të kontribuojë në zbatimin efektiv të sistemit për administrimin e rrezikut, si dhe në veçanti në parashikimin dhe vlerësimin e rrezikut.”.

Neni 74

Në nenin 240, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 1, fjalët “... nr. 9917, datë 19.5.2008,...” dhe “...të ndryshuar...”, hiqen.

2. Në fund të pikës 2, shtohen fjalët, “...të cilat mbahen në një regjistër të veçantë.”.

3. Pas pikës 2, shtohet pikat 3 me përmbajtje si vijon:

“3. Autoriteti mban të dhëna për çdo raportim lidhur me rreziqet e mashtrimeve në sigurime, sipas pikës 2, të këtij neni.”.

Neni 75

Në nenin 259, pika 3, shfuqizohet.

Neni 76

Neni 261, i ligjit, shfuqizohet.

Neni 77

Nenet 264, 265 dhe 266 të ligjit, shfuqizohen.

Neni 78

Në nenin 268, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 3, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“3. Për mbrojtjen e kreditorëve, zotëruesve të të drejtave të veçanta dhe titullarëve të interesave, të cilët e kundërshtojnë shndërrimin, zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.”

2. Në fund të pikës 4, fjalët “...e nenit 224, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, të ndryshuar”...”, zëvendësohen me fjalët “... ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 79

Në të gjithë tekstin e ligjit bëhen ndryshimet në shprehje, si më poshtë:

1. Fjalët “Qendra Kombëtare e Regjistrimit”, zëvendësohen me fjalët “Qendra Kombëtare e Biznesit” dhe akronimi “QKR” zëvendësohet me akronimin “QKB”, sipas kuptimit të fjalisë.

2. Fjalët “ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar” zëvendësohen me fjalët “ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, sipas kuptimit të fjalisë.

3. Fjalët “nënshkrimi i kontratës” zëvendësohen me fjalët “lidhje e kontratës”, sipas kuptimit të fjalisë.

4. Fjalët “auditues i jashtëm” zëvendësohen me fjalët “auditues ligjor”, sipas kuptimit të fjalisë.

5. Fjalët “Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e Inteligjencës Financiare”.

Neni 80

Dispozita kalimtare

1. Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me

kusht që brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtatin veprimtarinë e tyre me kërkesat e këtij ligji.

2. Autoriteti miraton aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 81

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

ELISA SPIROPALI